

platforma

CiviKos

A blue curved line graphic that starts under the 'C' and ends under the 's', resembling a smile or a swoosh.

ANALIZË

Pjesëmarrja e OSHC-ve anëtare në
Platformën CiviKos në konsultime
publike gjatë vitit 2013 – 2014

Autor: Sekretariati i Platformës CiviKos

2015 Platforma CiviKos

Publikuar nga: Platforma CiviKos Rruga Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë Kosovë

Për më shumë informata: info@civikos.net

www.civikos.net

Hyrje

Pjesëmarrja e OSHC-ve anëtare në Platformën CiviKos në konsultime publike, konkretisht në kontributet e tyre në draft/ligje dhe udhëzime administrative është një hulumtim që Sekretariati i Platformës CiviKos e realizon çdo vit për të parë se sa OSHC-ë anëtare në CiviKos janë aktive në procesin e konsultimeve publike që Qeveria e Republikës së Kosovës realizon me OSHC-të kryesisht përmes formës elektronike e po ashtu edhe pjesëmarrjes direkte në grupe punuese, në fazat më të hershme të draftimit të ligjeve. Ky hulumtim i përfshinë vetëm organizatat anëtare të CiviKos, ku si metodologji janë përdorur pyetësorët e dërguar online tek anëtarët përmes Platformës Survey Monkey, ku janë mbledhur informata kryesisht kuantitative rreth pjesëmarrjes së OSHC-ve anëtare të CiviKos në konsultime publike gjatë viteve 2013-2014, si dhe janë realizuar intervista kualitative me disa organizata që kanë qenë më aktive në procesin e konsultimeve publike gjatë dy viteve të fundit. Pyetësorët janë implementuar në dhjetor të vitit 2013 dhe 2014, ndërsa intervistat janë zhvilluar gjatë muajve tetor- dhjetor 2014. Pyetësi i dërguar online ka qenë anonim ndërsa intervistat e hapura janë zhvilluar vetë me disa organizata anëtare ku janë potencuar në këtë analizë.

Platforma CiviKos

Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë e nisur në fillim të vitit 2007, që ka për qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë së Kosovës. Platforma CiviKos, pas një procesi të gjatë konsultimi e me pjesëmarrjen e mbi 130 organizatave të shoqërisë civile, më 9 Nëntor 2007 ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit mes Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë civile (të përfaqësuar nga Platforma CiviKos). Ky memorandum paraqet dokumentin e parë formal që parasheh përkushtimin e dyanshëm për një bashkëpunim institucional dhe partneritet të mirëfilltë në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Shoqërisë Civile. Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 05 korrik 2013 ka aprovuar Strategjinë Qeveritare dhe Planin e Veprimit për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017. Gjatë muajit shtator-tetor 2014 është bërë konstituimi i Këshillit për Mbikëqyrje të Strategjisë Qeveritare, ku me 15.10.2014 është mbajtur edhe takimi i parë i këshillit.

Shërbimi Informues i Platformës CiviKos për OSHC-të anëtare

CiviKos në vazhdimësi shpërndanë informata për anëtarët e saj të cilat informata janë të ndërlidhura me bashkëpunimin shoqëri civile- qeveri, po ashtu CiviKos shpërndan informata edhe në fusha tjera që janë relevante për shoqërinë civile. Në Kuvendin e fundit të anëtarëve që është mbajtur më 04.04.2014 Platforma CiviKos ka miratuar dokumentin: Rregullat e Procedurës për Zbatimin e Aktiviteteve të Platformës CiviKos¹ i cili dokument në mënyrë të detajuar tregon për Sistemin e Informimit të CiviKos, konkretisht neni 4 dhe 5. Në kuadër të informimit të vazhdueshëm për anëtarët e saj Platforma CiviKos shpërndanë informata duke u bazuar në këtë dokument. Përveç informatave të ndryshme si mundësi për grante, mundësi për pjesëmarrje në konferenca të ndryshme etj, Platforma CiviKos në një marrëveshje me Zyrën Ligjore të Kryeministrit të Kosovës duke u bazuar në nenin 32² të

¹ http://www.civikos.net/repository/docs/Rregullorja_e_Punes_per_aktivitetet_e_CiviKos.pdf

² Gjatë përgatitjes së propozimeve për të cilat kërkohet koncepti dokumenti, përveç konsultimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës publike sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, organi propozues duhet të publikojë përmbajtjen e propozimit kësaj për komente nga publiku dhe në mënyrë specifike do të kërkojë komente nga organizatat joqeveritare të cilat ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga propozimi.

Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 për konsultimet me publikun në vazhdimësi përcjellë dhe ndanë me anëtarët e sajë të gjitha draft/ ligjet dhe udhëzimet administrative për konsultim tek të gjitha organizatat anëtare.

Sekretariati i Platformës CiviKos përveç shpërndarjes së informatave me anëtarë në mënyrë të vazhdueshme monitoron të gjithë procesin e konsultimeve publike dhe organizon hulumtime dhe intervista me anëtarë, për t'i përmirësuar sa më shumë shërbimet ndaj anëtarëve. Gjatë një hulumtimi të zhvilluar me 53 organizata anëtarë nga të gjitha regjionet e Kosovës për shërbimin informues të Platformës CiviKos ndaj anëtarëve të sajë të realizuar gjatë periudhës tetor-dhjetor 2014 ka dalë se 88.7 % informatat e pranuar nga CiviKos i gjejnë shumë të rëndësishme dhe vetëm 11.3 deri diku të rëndësishme. Sa i përket fushave në të cilën dëshirojnë të pranojnë informata në të ardhmen janë njoftimet për mundësi për grante, draft /ligjet për konsultime publike, informata relevante rreth zhvillimit të shoqërisë civile etj. Forma përmes e-mailit mbetet si forma më e preferuar për pranimin e informatave nga anëtarët e CiviKos.

Pjesëmarrja e OSHC-ve në konsultime publike gjatë vitit 2013-2014

Gjatë vitit 2013 në Platformën CiviKos janë pranuar gjithsej 45 draft/ligje, dhe udhëzime administrative, nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministritë e linjës për konsultim, me shoqërinë civile. Nga 45 ligje që janë dërguar në adresë të CiviKos gjatë vitit 2013, 8 nga këto projekt ligje nuk janë dërguar në tri gjuhë zyrtare, shqip, serbisht, anglisht, dhe 35 projekt- ligje janë dërguar pa tabelë për komente dhe udhëzues shtesë se si duhet organizatat të japin kontributin e tyre.

Gjatë vitit 2014 janë dërguar gjithsej 48 draft/ligje dhe udhëzime administrative për konsultim me shoqërinë civile ku nga 48 draft/ ligje dhe udhëzime administrative 10 nga këto dokumente kanë ardhur vetëm në gjuhën shqipe. Në të gjitha këto draft ligje kanë munguar tabelat për komente, dhe udhëzues shtesë.

Tab.1. Draft/Ligjet dhe Udhëzimet administrative të përcjella nga Sekretariati i CiviKos tek anëtarët e sajë gjatë viteve 2013/2014

Viti	Draft/Ligje dhe UA të shpërndara nga CiviKos tek anëtarët.	Draft/Ligje dhe UA që nuk kanë ardhur në tri gjuhë Shqip, Serbisht dhe Anglisht.
2013	45	8
2014	48	10

Për ta lehtësuar procesin e konsultimeve publike Platforma CiviKos ka vendosur në ueb- faqen www.civikos.net udhëzuesin për procesin e konsultimeve publike i cili udhëzues është punuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) së bashku me Qeverinë e Kosovës, dhe është dokument zyrtarë i cili iu shërben të gjithë të interesuarve që dëshirojnë të marrin pjesë në konsultime publike.

Për të parë se sa janë aktive organizatat anëtare në këtë proces të konsultimit gjatë muajve dhjetor 2013 dhe 2014 është dërguar nga një pyetësor tek anëtarët e CiviKos-it, ku janë pyetur rreth kontributeve të tyre në projektligje dhe konsultime publike në përgjithësi që Qeveria e Kosovës organizon për OSHC-të.

Rezultatet e hulumtimit

Gjatë vitit 2013³ nga 26 OSHC që janë përgjigjur në këtë pyetësor del se 13 prej tyre kanë marrë pjesë disa herë në konsultime publike, 8 asnjëherë, dhe 5 prej tyre vetëm një herë. Duke analizuar arsyen e mos- pjesëmarrjes në konsultime publike nga 12 organizata që janë përgjigjur 6 prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë ekspertizë në fushën e caktuar, 4 prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë informacione se si të japin kontributin dhe vetëm 2 prej tyre nuk besojnë se kontributi i tyre do të merret parasysh.

Organizatat që kanë marrë pjesë në konsultime publike deklarohen se 17 prej tyre nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje nga personat përgjegjës, 3 vetëm në 1 rast, dhe 5 kanë pranuar disa herë përgjigje për kontributet e tyre të dërguara me shkrim.

Ndërsa gjatë vitit 2014 nga 11 organizata që janë përgjigjur në pyetësor, 4 deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në konsultime publike, 6 disa herë, dhe vetëm 1 organizatë ka marrë pjesë vetëm njëherë. Nga ata që kanë marrë pjesë në konsultime publike vetëm 1 organizatë ka pranuar përgjigje nga personat përgjegjës ndërsa 6 prej tyre asnjëherë.

Për pyetjen se cilat janë arsyet e mos pjesëmarrjes në konsultime publike del se 3 nga organizatat konsiderojnë se nuk kanë ekspertizë në fushën e caktuar, dhe 3 nga organizatat mendojnë se kontributi i tyre nuk do merrej parasysh. Ndërsa ndër arsyet tjera është mungesa e kohës nga organizatat, neglizhenca e përgjithshme si dhe mungesa e draft/ligjeve që lidhën ngushtë me fushë-veprimin e organizatës.

³ Shiko tabelën e rezultateve në fundë të këtij hulumtimi

Sipas Indeksit Kosovar për Shoqëri Civile⁴, 64% e OSHC-ve deklarojnë që kanë qenë të përfshira në procesin e hartimit të politikave, gjatë tre viteve të fundit. Megjithatë, vetëm 29.29% e OSHC-ve deklarojnë që kanë qenë të ftuara rregullisht për konsultime për ligjet/politikat e lidhura me fushën e tyre të veprimit.

Tab.2 .Pjesëmarrja e OSHC-ve anëtare të CiviKos në konsultime publike gjatë vitit 2013/2014

Viti	OSHC-te e intervistuar	Kanë marrë pjesë në konsultime publike	Nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në konsultime publike	Kanë pranuar përgjigje nga personat përgjegjës	Nuk kanë pranuar asnjëherë përgjigje nga personat përgjegjës	Arsyet e mos-pjesëmarrjes- Nuk kanë ekspertizë, dhe nuk dinë si të japin kontributin	Mendojnë se kontributi i tyre nuk merret parasysh
2013	28	18	8	5	17	10	2
2014	11	7	4	1	6	3	3

⁴ http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/14_04_2014_2142029_Indeksi_Kosovar_i_Shoqerise_Civile_shqip_web.pdf

Intervista me OSHC-të anëtare në CiviKos që kanë marrë pjesë në konsultime publike gjatë vitit 2013-2014

Në intervistat e zhvilluara me disa OSHC anëtare në CiviKos që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimeve publike gjatë dy viteve të fundit tregohen përvojat e pjesëmarrjes në konsultime publike dhe sfidat që kanë hasur gjatë këtij procesi.

Organizata YIHR (Youth Initiative For Human Rights in Kosovo) ka marrë pjesë më shumë se në 5 konsultime publike për projektligje të ndryshme si: Ligji Për Avokatin e Popullit, Ligji Për Mbrojtje Nga Diskriminimi, Ligji Për Mbrojtjen e të Dhënave, etj.

Sipas YIHR Kontributi më i madh ka qenë në Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, ku si OJQ kanë dhënë kontribut të madh. “Vlen të theksohet se me kërkesën tonë është shtyrë i gjithë procesi ku pastaj me kontributin tonë kemi ndryshuar pothuaj se çdo nen të këtij projektligji. Ka qenë presion i organizatave ndërkombëtare si OSBE dhe gjithashtu mbështetja nga këto organizata që ne të përfshihemi dhe kontribuojmë në këtë projektligj”, thotë Edona Tolaj koordinatore e projekteve në YIHR.

“Mirëpo ka raste që në disa projektligje ku kemi dërguar kontribute me shkrim, asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje nëse është marrë parasysh kontributi jonë apo jo. Po ashtu ndodhë që komentet që i dërgojmë inkorporohen pjesërisht dhe sipërfaqësisht.”

Disa nga sugjerimet për CiviKos nga YIHR janë që të organizojë sa më shumë takime me OSHC-të dhe të avokojë në rëndësinë e pjesëmarrjes së OSHC-ve në politikë bërje, gjithashtu të nisë iniciativa për projektligje të ndryshme që OJQ-të që kanë misionë të njëjta t'i koordinojnë së bashku kontributet e tyre dhe të jenë më të zëshme, dhe këmbëngulës.

Ndërsa organizata KIPRED ka marrë pjesë në më shumë se 5 projektligje, dhe kontributet e tyre i dërgojnë vetëm në fushat që kanë ekspertizë. Disa nga projektligjet që kanë dhënë kontribute janë: Projektligji Për Zgjedhje, Ligji Për Financat Publike ku kontributet e tyre janë marrë parasysh dhe janë inkorporuar. Në Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm edhe pse kanë bërë kërkesë si organizatë që të kontribuojnë nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga zyrtarët përgjegjës. Ndër vështirësitë që hasin si organizatë në kontributet e tyre është se mungon arsyetimi (feedback-u) nga ministritë për arsyen e mos futjes së sugjerimeve në nene të caktuara që dërgohen si kontribute në formë të shkruar. KIPRED sugjeron që CiviKos të dërgojë projektligjet vetëm në bazë të fushëveprimit të OJQ-ve, dhe të dërgojë projektligje që vijnë jo vetëm nga Qeveria e Kosovës por edhe nga Kuvendi i Kosovës.

Samir Reka nga Organizata INPO mendon se konsultimi online- përmes e-mailit nuk është njëra nga format më të mira pasi nuk ka një mënyrë të strukturuar se kush i pranon ato komente dhe si do të inkorporohen, ndërsa kur organizohen punëtori për draft-ligje që prekin sferën e organizatave të caktuara atëherë është më e lehtë pasi fuqia e argumentit është më e madhe gjatë punëtorive. Organizata INPO më shumë ka kontribuar në konsultime publike që ministritë e linjës kanë organizuar në formë të punëtorive se sa në formën online, përmes e-maileve.

Sipas Z. Reka, Platforma CiviKos duhet të avokojë më shumë që ministritë e linjës të organizojnë punëtori për draft/ligje të caktuara dhe të ftohen palët e interesit, në mënyrë që kontributi të jetë më i strukturuar. Ndërsa sa i përket formës online të konsultimeve do të ishte mirë që të krijohej një platformë online e veçantë ku të gjitha draft ligjet për konsultim të publikohen aty dhe organizatat të mund të kontribuojnë në mënyrë më aktive.

Përcjellja e të gjitha draft-ligjeve nga CiviKos tek anëtarët për konsultim publik është shumë e mirëseardhur dhe dobiprurëse për organizatën Handikos. Osman Shatri, këshilltar ligjorë në Handikos mendon se përcjellja e të gjitha draft-ligjeve pa marrë parasysh fushëveprimin e organizatave është e mirëseardhur, sepse në shumicën e ligjeve mund të gjejmë pjesë që ndërlidhen me fushëveprimin tonë. Shembull është Ligji i Aviacionit Civil i cili nuk ndërlidhet direkt me fushë-veprimin e Handikos, por në kuadër të këtij ligji rregullohet edhe udhëtimi i personave me aftësi të kufizuara parapëlqyesh dhe tetrapëlgjikë, ku kontributi i Handikos në këtë rast do të jetë shumë i rëndësishëm.

Handikos pranon në vazhdimësi të gjitha draft/ligjet që CiviKos i përcjellë tek anëtarët dhe në përgjithësi merr pjesë në konsultime publike. Handikos ka sponsorizuar dy punëtori për draftimin e : “Projektligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Parapëlqyesh dhe Tetrapëlgjikë”, ku në bashkëpunim me Zyrën Ligjore dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë të Kryeministrit kanë punuar së bashku deri në finalizimin e projektligjit.

“Sa i përket ligjit për Sigurime Shëndetësore, si Handikos nuk kemi qenë të informuar e as të ftuar për konsultime publike dhe kemi arritur që të japim një pjesë të kontributit vetëm në fazën kur projektligji ka qenë në komision parlamentar dhe vetëm një pjesë e sugjerimeve janë marrë parasysh. Gjithashtu edhe në ligjin për Skemat Pensionale nuk kemi marrë ftesë për kontribute”, potencon Z. Shatri - Këshilltar Ligjor në Handikos.

“Platforma CiviKos duhet të ketë marrëveshje me të gjitha ministritë e linjës në Kosovë që të gjitha draft/ligjet dhe udhëzimet administrative të përcillen tek shoqëria civile për konsultime pasi nga disa ministri nuk marrim ftesa fare, dhe të avokojë më shumë që shoqëria civile të inkorporohet qysh në fazat e para të hartimit të projektligjeve, e gjithashtu edhe të monitorojë implementimin e projektligjeve.”

Në intervistat e zhvilluara me organizata që kanë marrë pjesë në konsultime publike dhe kanë dhënë kontributin e tyre në draft ligje të ndryshme del se mesatarisht gjatë një viti këto OJQ kanë marrë pjesë në konsultime publike ose kanë dërguar kontribute më shkrim në më shumë se 5 projekt/ligje të ndryshme.

Disa nga sugjerimet e përgjithshme që kanë dalë nga ky konsultim janë :

- **Qeveria duhet të ftojë organizatat e shoqërisë civile në procesin e hartimit të ligjeve, qysh në fazat e saj fillestare, sepse gjatë procesit të konsultimeve me e-mail, nuk po merren parasysh kontributet.**
- **Të organizohen takime konsultative me grupe të ngushta të OJQ-ve të cilat janë të profilizuara në fusha të caktuara.**
- **Të krijohet një Web-faqe e veçantë për procesin e konsultimeve publike me përfaqësues të OJQ-ve, ku të bëhen publike kontributet e përfaqësuesve të OJQ-ve në mënyrë që procesi të jetë transparent për publikun e gjerë.**
- **Të kategorizohen OSHC-të sipas fushë-veprimtarisë dhe të ju dërgohen për konsultim vetëm ato projektligje që janë në fushëveprim të tyre.**
- **Të dërgohen arsyet e mos inkorporimit, të komenteve, në projekt-ligje të ndryshme.**
- **Të organizohen takime më të shpeshta avokuese me OJQ për rëndësinë e pjesëmarrjes së organizatave në konsultime publike që organizon Qeveria e Kosovës.**
- **Të organizohen trajnime për OSHC-të se si të japin kontribute në procesin e konsultimeve publike.**
- **OSHC-të që kanë misione dhe fushëveprime të njëjta të bashkëpunojnë që kontributet ti dërgojnë si një trup e vetme.**

Disa nga parregullsitë në procesin e konsultimeve publike

Sekretariati i Platformës CiviKos në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar të gjitha draft ligjet që kanë ardhur për konsultim, duke u siguruar që të respektohet afati kohor sipas nenit 32 të Rregullores së Punës së Qeverisë 09/2011 dhe të gjitha draft-projektligjet dhe udhëzimet administrative të përcillen së paku në dy gjuhë shqip dhe serbisht.



Me 29.10.2014 është dërguar për konsultim publik **Draft Udhëzimi Administrativ për Lirim me Kusht**, ku si dokument ka qenë vetëm në gjuhën shqipe. Pasi janë kontaktuar zyrtarët përgjegjës nga Sekretariati i Platformës CiviKos, dy ditë më vonë është dërguar edhe versioni në gjuhën serbe ku i'u është përcjellë edhe anëtarëve të cilët gjuhë primare e kanë gjuhën serbe.

Me 12.11.2014 është dërguar për konsultim dokumenti **“Konsultime paraprake për Draft KD për rregullimin e të drejtës ndërkombëtare private/kolizionit të ligjeve”** nga Ministria e Drejtësisë ku versioni në gjuhën serbe ka munguar. Janë kontaktuar personat përgjegjës por nuk kemi marrë versionin në gjuhën serbe, me arsyetimin e vetëm se nuk mund t'i përkthejnë draftet në të gjitha fazat e konsultimeve .


Me 09.12.2014 është dërguar për konsultim **“Draft- ligji kundër Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit”**. Koha për konsultim nuk ka qenë 15 ditë si e parasheh Neni 32 i Rregullores së Punës së Qeverisë 09/2011. Organizata anëtare e CiviKos KCSF ka reaguar duke kërkuar që të shtyhet ky afat në pajtim me Rregulloren e punës së qeverisë. Gjithashtu nga Sekretariati i Platformës CiviKos është kërkuar që të gjitha draft-dokumentet të dërgohen në të dy gjuhët shqip dhe serbisht. Të gjitha kërkesat janë marrë parasysh dhe ky draft ligj është përcjell tek të gjithë anëtarët.

Ndërsa sa i përket dokumenteve **Projekt Rregullore për Kushtet e Punës dhe Kompensimi në Rast të Paaftësisë së Shkaktuar në Punë, për të Burgosurit dhe Projekt Udhëzim Administrativ për Procedurën e Lirimit me Kusht**, që janë përcjellë për konsultim nga Ministria e Drejtësisë, edhe pas kontaktimit nga Sekretariati i Platformës CiviKos se mungon versioni në gjuhën serbe, nuk është dërguar ai version me arsyetimin se në këtë fazë të drafteve nuk mund ti përkthejmë.

Anex 1 Përgjigjet e pjesëmarrësve për procesin e konsultimeve të Draft Ligjeve/Udhëzimeve Administrative mes OSHC-ve (Organizatave të Shoqërisë Civile) në Kosovë, dhe Qeverisë/Institucioneve Publike/ 2013.




Anex 1 Përgjigjet e pjesëmarrësve për procesin e konsultimeve të Draft Ligjeve/Udhëzimeve Administrative mes OSHC-ve (Organizatave të Shoqërisë Civile) në Kosovë dhe Qeverisë/Institucioneve Publike/ 2013.



Anex 2 Përgjigjet e pjesëmarrësve për procesin e konsultimeve të Draft Ligjeve/Udhëzimeve Administrative mes OSHC-ve (Organizatave të Shoqërisë Civile) në Kosovë dhe Qeverisë/Institucioneve Publike/2014.



Anex 2 Përgjigjet e pjesëmarrësve për procesin e konsultimeve të Draft Ligjeve/Udhëzimeve Administrative mes OSHC-ve (Organizatave të Shoqërisë Civile) në Kosovë dhe Qeverisë/Institucioneve Publike/2014.



Adresa: Rr. Bedri Pejani 7/A
10000, Prishtinë.

Tel.: +381 (0) 38 224 904

info@civikos.net

www.civikos.net